

29. *Kaliniku dhe Theodota, Deshmoret e Shenjte.*
30. *Silla, Silluani, Kreskenti, Epeneti dhe Androniku, prej te Shtatedhjete Apostujve te Shenjte.*
31. *Evdokimi i Shenjte dhe i Drejte.*

TE KREMTET E GUSHTIT

1. *Shetitja e Kryqit ne Kostandinopoje; te Shtate Djemat e Shenjte te Makabenjve, e jema e tyre Sollomona, dhe mesonjesi i tyre Eleazari.*

2. *Trasferimi i lipsanit te Shen Stefanit, kryedhjakut edhe Deshmorit te Pare.*

PERLGSHORJA E SHEN STEFANIT, T. IV.

Kurore prej Mbreti ke, mi kokcn o Shen Stefan, per vojtjet e tmerrshime, per Zotin tone Jesus, i Par' i Deshmoreve; se ti i kallezove marresit' e Judenjve, dhe e pe Shpetimtarin, me te djathten e Atit. Atje pra nermjetó gjithenjé, te shpetohen shpirtet tona.

3. *Isaazi, Dalmati dhe Fausti, Aterit tane Oshenare.*

4. *Te Shtate Djemat e Shenjte te Efeses.*

5. *Parekremtja e Shperfytyrimit; Eusigni, Deshmori i Shenjte.*

6. *Shperfytyrimi (Shen Sotiri).*

PERLGSHORJA E SHPERFYTYRIMIT, T. R, METEMORFOTHIS EN TO ORI

Ndrove fytyren permi malin o Krisht Perendí, ndrite si nje Mesí per Dishépujte, ashtú sic merrnin vesh. Çfaq-e dhe per né driten me lavdí, qe ndrit ne qellin gjithenjé, me lutjet e Shen Marise, Dritedhenes lavdí me ty.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Sot Jesú Krishti vjen, në malin e Thaborit, edhe ia ndron Adamit, stolín' e vjetëruar, me dritë dhe me lavderím.

Ejani në Thabór, të ndritur me virtuta, ta shohim Shpëtimtarin, që shkrepëtín me reze, si Zot' i gjithë dríteve.

Díelli ndrit mi dhé, dhe perëndón për mbreme, dhe Krishti me lavdine, shkelqeu përmi malin, mi botën e besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Arthnë në mal Thabór, Eлли Moisiu, dhe panë Jesú Krishtin, që lindi prej Marisë, për ndjesën e mekátave.

PASVARGJET, T. I, TON URANION

Në mal Thabór Jesú Krishti vajti me Pjetrin tok, Joanin dhe Jakobin, dhe fytyra i ndriti, si díelli shkelqeu plot me lavdí, dhe u-shtanknë Dishëpujtë, se nukë dinin ç' kuptím kishte kjo çudí, për shpëtimin e besnikëve.

Eлли dhe Moisiu vajtin në mal Thabór, ta shohëronin Krishtin, dhe atjé të deshmonin, që ky do ta leçitë ligjën e re, për shpëtimin e njëresve, dhe do të vuanjë vdekje vullnetarisht, për ringjalljen e të vdekurve.

Në mal Thabór Jesú Krishti shkrepí si díelli, me roba si dëborë, vetëtinte shkelqente, dhe reja e rethój me drit' e lavdí, edhe Ati prej qíellit, si Bir të dashur të vetem e proklamój, për shpëtimin e besnikëve.

LAVDI DHE TANI, T. II. Pjeter Jan dhe Jakób, o Apostúj te zgjedhur, e pate kur ju ndriti, dhe Atin e degjuat, kur Bir te vet' e proklamój.

NDENJESORET, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Si e qysh do t' i ndryshósh, te gjithë njërezit mi dhé, perserí kur te na vish, te na gjykósh përfunderisht, na e tregove me çpërftyrimin; me Profetin Moisi, dhe Shent Elline tok, u-fanese ne Thabór, dhe u-ndriçuat me lavdí, dhe u-çuditne Dishépujte kur te pane; me até drite, ndritna shkelqena, shpirtet tona o Zoti Krisht.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

Ne Thaborin o Jesú, ndrove fytyren me lavdí, edhe reja te mbulój, me vetctím' edhe shkelqím, dhe u-çuditne te gjithë Dishépujte; edhe rane permi dhé, se drita jote i verbój, edhe nuk shihnin dot, rezet e ndrícime, qe shkrepctinin si díell nga fytyra jote; me até drite, ndritna shkelqena, shpirtet tona o Zoti Krisht.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

T. IV, O IPSOTHIS

Tok me Dishépujte u-ngjit mi Thaborin, edhe shkelqeu me lavdine qellore, dhe Moisiu ish me Shent Elline atjé, Ligja dhe Profetet pra, Perendís' i sherbejne, Bir te tij e deklarój, Ati yne nga qelli, dhe çdo besnik ashtú e njeh taní, pra e hymnoje, me Atin dhe Shpirtin Shenjt.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperoheni prej Zotit, dhe do te fishkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete cdo shpirt, dhe lartesohet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jete-lindje.

PARËVARGU. Thabori dhe Hermoni do te ngazellohen me emrin tent.

UNGJILLI I MËNGJESIT PAS LUKAJT

M' atë kohë, Jesúj mori Pjetrin dhe Joanin dhe Jakobin, dhe u-ngjit ne mal qe te falej. Dhe tek po falej, pamja e fytyres iu-ndryshua, edhe roba iu-be e bardhe si vetetime. Dhe ja ku po flisnin me atë dy burra, te cilet ishin Moisiu dhe Elliu, edhe te cilet u-fanesne me lavdi, dhe tregonin per vdekjen e tij, e cila do te ngjante ne Jerusalém. Po Pjetri me shoket ishin te renduar nga gjumi, dhe kur u-zgjuan, e pane lavdine e tij dhe te dy burrat, qe flisnin me atë. Edhe kur atá po largoheshin, Pjetri i tha Jesújt: "Mesonjes, eshte mire te mbétemi ketú. Pra, le te bejme tri tenda, nje per ty dhe nje per Moisine dhe nje per Elline." Se nuke dinte seç thoshte. Dhe kur po thoshte ketó ardhni nje re, dhe i mbu-

lój, dhe u-trempne, kur hynë brenda në rene. Dhe një zë ardhë prej rene dhe tha: “Ky është im-Bir i dashur; dëgjójëni.” Dhe passi u-dëgjua zëri, Jesúj u-gjet i vetem. Dhe atá heshtne, dhe nuk i thanë asgjé askújt ató ditë seç’ kishin parë.

Psalmi 51 pa zë.

LAVDI. Me nermjetimet e Apostújve, o më-shireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndëses, o më-shireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít’ e mia.

T. II. Njérczit i bekón, o Zot me driten tende, dhe né pra të therresim, o Zot i zemerdhempshur: Shpëtona prej mekátave.

SHKURTORJA, T. R.

Kjo Shkurtore këndohet në Meshe pas hyrjes së Vogel që më 27 të Korrikut gjer më 13 të Gushtit.

Permi malin ndrove fytyren, dhe ua çfaqë lavdine tende Dishépujve, o Krisht Perendí siç e merrnin vesh, dhe kështú kur të panë permi Kryq pastáj, kupetuan që ish një pesím vullnetár, dhe leçitne kudó mi dhé, se ti je vertét o Zoti Krisht, agullimi i Atit.

SHTËPIA

Ngréhuni, o të ngathet, mos u-zvarnisni përdhé; fluturoni përpjetë, o mejtime, që na e krusni shpirtin përdhé; le të ngjitemi në Thabór pra-

ne Pjetrit dhe te bijve te Zebedeut, qe ta shohim lavdine e Krishtit, edhe ta degjojme zerin nga qelli, qe e proklamón agullimin e Atit.

SINAKSARI

Me gjashte te ketí múaji kujtojme Shperfytyrimin e Zotit edhe Perendise dhe Shpetimtarit tone Jesú Krisht.

E atí eshte lavdia dhe fuqia ne jetet e jé-teve. Amin.

ZBRITCSORET, T. T. IV, STAVRON KHARAKSAS

I. Nje Kryq vijosi me shkop, Moisi Profeti, dhe Det' i Kuq u-ça me dysh, dhe Israeli shkoj pertéj; pastáj prape e bashkój, me nje tjater shkop dhe Kryq, persiper válave, dhe forcat edhe qeret, Faraonit ia mbyti; pra Krishtin kendojme si Perendí dhe Zot, me brohorí dhe gas.

III. Shkopi nje here si nje simból i misterit na u-çfaq; se filizat na treguan prifterine, edhe per Kishen beronje, ja ku mbiu edhe lulczój, Kryqi taní, per force dhe per shigurím.

IV. Kam degjuar o Zoti Krisht, si e regullove keté mistér te math, kupetova veperimin tent, dhe te lavderova Perendia im.

V. O Drur' i lumur tri here, permi te cilin undé, Mbret' i larte Zoti Krisht, se prej teje u-rrezua djalli gjarper, i genjyer tmerrcrisht, prej Zotit te mberthyer permi Kryq, q' u fal shpírteve, perdellím dhe paqe gjithenjë.

VI. Në barkun e bishes së detit, Profeti Shen Joná, dúarte i zgjeróje në formë Kryqi, dhe pesimin e Krishtit parëtrëgonte kjarisht, pra i triçim jashtë u-hoth, dhe lajmen e perminatýreshme e parëlaimeróje, të Jesújt të mberthyer mi Kryqin për në, që na e ndriti krijesën, me ngritjen prej várreve.

VII. Urdher të çmendur dha, tirani beselík, e tundi pópullin, botën e tmerróje, me blasfemí dhe paudhesí, po të Tre Djemat nuk i tronditi dot, tërbimi i eger, as furra me zjarr; dhe kur u fryri era vesprúrese, kendonin brenda mun në zjarr: I permi hymnuar je, Perendí dhe Zot i Math, për jetë i bekuar.

VIII. E bekoní Djema, si Trinia nga númeri, Atin qëllór të vétëmin Zot, hymnoni Fjalën që mi dhënë zbriti, dhe e bëri vesë zjarrin e fúrrave; dhe e lartësoni, dhe Shpirtin e Terreshenjtë, që u dhuróje që të gjithëve jetën.

MADHESHTIMET

Në Madheshtimet këndohen Troparet pasónjese:

IX. O Hyjlíndese Parajse mistike je, se pa lërim lulezove Zotin Krisht, që mbolli permi dhé, jetëprúresin Kryq, që po lusim me besë, se ky po lartësohet, dhe me anën e tij, ty të madheshtojmë sot.

Mallkím' i vjeter i stërgjyshit, që rodhi nga farmaqi i gjárperit, u-abolít me Kryqin e Zotit Krisht; bekimi ardhí prapë për njerinë me Marí

Hyjlíndesen, qe na lindi Jesune çlirónjesin; te gjitha pra fuqite, e lavderojne ne qiëllin.

DERGIMESORJA, T. III, EPESKEPSATO

Fjal' e Drite pa ndryshím, o Shpëtimtár o Zoti Krisht, qe na shkelqén nga qiëlli, dhe solle driten permi dhé, sot u-fanese ne Thabór, perpara Apostujve, me driten e Shpirtit Shenjt.

LAVDERIMET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Ne Mal Thabór Zoti Krisht, mori tre prej Dishépujve, atá mé te zgjédhurit, dhe u çfaqí lavdín' e tij; si Bir i Atit, ndriti si díelli, dhe u-çuditne, rane permbýs mi dhé; thirrne me ze te math: Ti je Zot dhe Perendí o Jesú Krisht, drita e perjétslime, qe kurre s' perendón.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Profét' i Math Moisé, qe nga mali Siná i dha, porrosirat e medhá, Israilit per gjithënjé; dhe Shent Elliu, shkaba qe fluturój, me qere zjarri, lart midis flágeve; arthne ne mal Thabór, qe te flasin tok me ty se taní shkon, ne Jerusalém te vdeç, o Krisht per njërezit.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Nje re e ndríçime ra, permi ty edhe te rrethój, me Profetin Shent Ellí, dhe Profetin Shen Moisé; dhe u-degjua, zeri nga qiëlli, qe te leçiti, Bir mé te dáshurin; eni degjójeni, se ky eshte Jesú Krishti Shpëtimtár, qe ka zbritur permi dhé, per hir te njëresve.

LAVDI DHE TANI, T. T. IV. Jesúj mori me vete, Pjetrin dhe Joanin dhe Jakobin, dhe u-ngjiti ne nje mal te larte, dhe ndroj fytyre perpara syresh, edhe ndriti si díelli, dhe robat iu-zbarthne si drite. Dhe Moisiu me Elline flisnin me té, dhe nje re e ndrícime i mbulój, dhe nje ze u-degjua prej resc: “Ky esht im-Bir i dashur, qe me ka pelqyer, keté degjójeni.”

HYRTORJA

Thabori dhe Hermoni do te ngazellohen me emrin tent. Shpetona o i Bir' i Perendise, qe u-shperfytyrove ne Mal Thabór, né qe te kendojme Alilluia.

SHKURTORJA, T. R, EPI TU ORUS

Permi malin ndrove fytyren, dhe ua çfaqe lavdine tende Dishépujve, o Krisht Perendí siç e merrnin vesh, dhe keshtú kur te pane permi Kryq pastáj, kupctuan qe ish nje pesím vullnetár, dhe leçitne kudó mi dhé, se ti je vertét o Zoti Krisht, agullimi i Atit.

APOSTULLI

Sa te medhá jane veprat e tua, o Zot; te gjitha i ke bere me urtesí. Bekoje Zotin, o shpirti im.

Prej Letres II se Pergjithme te Pjetrit.

Vellezer, perpíquni mé teper ta mbaroni punen, per te cilen jini thirrur dhe jini zgjedhur prej Perendise, se po ta beni keté, nuke do te mekatonni kurrc. Se atchere e kini ploterisht te shi-

guruar hyrjen në Mbretërinë e pasosur të Zotit tonë Jeshu Krisht. Perandaj nuk do të përtënj tju kujtonj gjithënjë, ndonëse e dini, dhe jini të vendosur me themël në të vërtetën e tanishme. Po besoj se është mirë tju kujtonj sa jam i gjallë, se për se shpejti do tju le shendet, sikunder ma ka detyrë Zoti ynë Jeshu Krisht. Edhe do të përpqem që këtë gjë ta kujtoni edhe pas vdekjes sime. Se nuk jua kemi leçitur fuqinë dhe ardhjen e Zotit tonë Jeshu Krisht me prallë të ujdësura me mjeshtëri, po me fakte, se e kemi parë me sy madhështinë e tij. Se u-nderua dhe u-lavdërua prej Perëndisë dhe Atit tonë qellor, kur e proklamoj me zë: “Ky është im-Bir i dashur, që më ka pelqyer.” Edhe këtë zë e degjuam që ardhni nga qelli, kur ishim bashkë me atë në malin e shenjës. Edhe kemi një shiguri më të madhe edhe nga fjalet e Profetëve, të cilat bëni mirë që i vëni re si një kandil, që ndrit në një vent të erret gjer sa të gëdhiet dita dhe të lindë ylli dritëprurës në zemrat tuaja.

UNGJILLI PAS MARKUT

M’atë kohë, Jeshu mori Pjetrin dhe Jakobin dhe Joanin, të vëllanë, dhe u-ngjijt në një mal të lartë veçanë. Edhe u-shpërfytyrua përpara syresh, edhe fytyra i ndriti si dielli, dhe robat iu-zbarthnë si drita. Dhe ja ku u-dukën Moisiu dhe Elliu, që kuvendonin me atë. Edhe Pjetri i tha Jeshut: “Është mirë, o Zot, të mbëtemi

ketú; po te duash, munt te bejme tri tenda, nje per ty dhe nje per Moisine dhe nje per Elline.” Edhe kur po thoshte ketó fjale, ja ku i mbulój nje re e ndrícime, edhe nje ze prej rese tha: “Ky esht im-Bir i dashur, qe me ka pelqyer; degjóje-ni.” Dhe Dishépujte, kur i degjuan ketó fjale, utrempne fort, edhe rane permbýs. Edhe Jesúj i preku, dhe u tha: “Ngréhuni, dhe mos kini fri-ke.” Dhe kur i ngritne syte, nuke pane tjater njerí pervéc Jesújt. Edhe kur zbrisnin nga mali, Jesúj i porrositi, dhe u tha: “Mos i tregoni as-kújt per keté vizión, gjer sa te ngjallet prej se vdékuresh i Biri i njeriut.”

MADHESHTIMI, T. IV, NIN TA ANIKUSTA

Te padegjúarat u-degjuan; se pa áte lindi Bir' i Virgjereshes, dhe deshmohet nga qelli me lav-dí prej Atit, si Perendí dhe si njerí, gjithaý per gjithë jetet.

KUNGATORJA

Me driten e lavdisë dhe fytyres sate, o Zot, do te baresim per jete.

7. *Dometi, Deshmori i Shenjte.*
8. *Emiliani, Konfessori i Shenjte, peshkopi i Kizikes.*
9. *Matthia, Apostulli i Shenjte.*
10. *Lavrenti, kryedhjaku dhe Deshmori i Shenjte.*
11. *Eupli, dhjaku dhe Deshmori i Shenjte.*
12. *Foti dhe Aniketi, Deshmoret e Shenjte.*

PERLESHORJA E DËSHMOREVE, T. IV,

Dëshmoret e tu o Zot, me vajtje lot e mundim, kurorë të ndriçime prej teje m'uarne, si roge dhe si çpërblim; se me fuqinë tënde, i rrezuan tiranët; edhe i shtypnë djajtë, e kuximt' e të dobët; atë për në po të luten o Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

13. *Maksimi, Ati ynë Oshenár.*

14. *Parekremtja e Fjetjes së Shen Marisë; Mikaj, Profeti i Shenjtë.*

15. *Fjetja e Shen Marisë.*

PERLESHORJA E FJETJES, T. I, EN TI JENISI.

Në lindjen tënde virgjërinë e rruajtë, në fjetjen tënde s' e neverite, botën o Virgjëreshë; në jetën e qellit shkon, jetën si lindë ketu mi dhë, dhe i shpëton gjithënjë prej vdekjes, shpirtet tona o Hyjlindëse.

THIRRTORËT, T. I, TON URANION

Kur u-vendose në varrin jetëburonjëse, u-bere si një shkallë që prej dheut në qellin; gezohu ti o fshat me nam Gjethsemani, që e prite Hyjlindësen, dhe në besniket thërresim me ngazellim: O Hirplote e bekuar je.

U-bere fron i të Lartit Zonjë Hyjlindëse, se sot na fluturove, që prej dheut në qellin, dhe rri e fronesuar pranë Jesujt, në Parajsën e driteve,

dhe né besniket therresim me ngazellim: O Hirplote e bekuar je.

Ta lavderojme te kremten Zonje Hyjlindese, me Forcat Engjellore, Kerubimet me flete, dhe gjithc Serafimet plot me lavdi, te hymnojn' o Hyjlindese, dhe né besniket therresim me ngazellim: O Hirplote e bekuar je.

LAVDI DHE TANI

T.I. Me urdher te perendishme, Apostújt' e Shenjte u-ngritne me nje re ne ere.

T. T. I. Dhe vajtin ta pershedoshin kufomen e Shen Marise.

T. II. Forcat Engjellore, zbritne qe te ndodhen ne varrimin.

T. T. II. Dhe u therrisinin Engjejve ne qell: Ja ku po vjen Virgjeresha e perendishme dhe mbretore.

T. III. Hápini portat, edhe priteni Nenen e Drites.

T. R. Se me anen e kesáj ardhi shpetimi i njé-cesve.

T. IV. Lavdia e saj kapercén çdo mendje.

T. T. IV. Pra nermjetó pa prere o Virgjereshe, dhe shpetoji besniket nga armiku.

T. I. Se ty te kemi te vétemen mprójtese, dhe ty te lumerojme per jete.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Eni o Apostúj, prej áneve te dheut, varrosni

Virgjereshen, që lindi Shpetimtarin, për ndjesën e mekátave.

Zonjë Hyjlíndese, o Nus' e Perendíse, o Mbretérësh' e qellit, o mburrje virgjërore, na shkove pranë Birit tent.

Grúmbulli sot u-mbloth, i gjithë Apostujve, prej áneve të dheut, që ta varrosin trupin, e Zonjës dhe Hyjlíndesës.

LAVDI DHE TANI. Zonjë lut-u për në, ngrer dúarte përpjetë, përpara Jesú Krishtit, dhe lyp-i të na falë, Parajsën e Shenjtóreve.

NDENJESORET, T. IV, KATEPELLAJI IOSIF

Thirr Davíd Profét dhe mbret, ç' ditë kremtojmë beserisht. Atë që kendove ti, me psallm' e këng' e brohorí, si Virgjëreshe dhe Nënë të Perendíse; se e mori lart në qell, dhe e vëndosi pranë tij, Shpetimtari Zoti Krisht, që prej saj lindi virgjërisht, dhe perandáj gëzohen nënat edhe bijat edhe thërresin: Lum' ti që shkove, në Mbretérín' e qellit.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

T. I, TON TAFON SU

U-mbothë gjithë tok, Apostújt' e Shenjtoret, në fshat Gjethsemaní, ta varrosnin me besë, kufomën e ndrícime, të Marisë Hyjlíndese, dhe me mallëngjím, edhe me lot e vajtojnë, dhe me ǃngjëjte, e lavderojnë me hymne, shumicat e njëresve.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

T. III, TIN OREOTITA

O Nen' e Zotit Krisht, Zonje Hyjlíndese, qe linde virgjérisht, vdiqe pavdekerisht, edhe çudí permi çudí na çfaqe o Virgjereshe: Si e pamartúara, lindi foshnjen e hýjeshme, si pastáj e vdékura si nje lule na myresón? Te gjithe pra therresim me Çngjellin: Gezohu o Zonje hirplote.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartsohet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARGVARGU. Do ta kujtónj emrin tent ne gjithe brezat e brézave.

UNGGJILLI I MËNGJEZIT PAS LUKAJT

M' ató dite, Mariama u-ngrit, dhe vajti me nxi-tím ne malesí, ne nje qytét te Judese, dhe hyri ne shtepine e Zaharise, dhe e pershendoshi Elisabeten. Dhe posá e degjój Elisabeta pershendoshjen e Marise, keceu foshnja ne barkun e saj. Dhe Elisabeta, e frymesuar prej Shpirtit te Shenjte, thi-

rri me zë të math, edhe tha: “E bekuar je ti në mes të grave, dhe e bekuar është pema e barkut tënt. Dhe si më ngjau kjo lumeri, që e-jema e tim-Zoti të më vizitonje? Se ja, posa më tingëlliu në veshet përshendoshja jote, më keceu foshnja në barkun më ngazëllim. Dhe lum’ ajó, që ka besuar, se do të përmbushen fjalet, që janë thënë prej Zotit për atë.” Dhe Mariama tha: “Madheshtoje Zotin, o shpirti im, edhe ti, o mendja ime, ngazëllohu më Perëndinë, Shpëtimtarn tim; se e hodhi syrin më shërbetoren e përunjur; se ja që-tani e tutje gjithë brezat do më lumërojnë; se më madheshtoj i Fuqishmi, dhe emri i tij është i shenjtë.” Dhe mbeti Mariama bashkë me atë një tre muaj, dhe pastaj u-kthye në shtëpinë e vetë.

Psalmi 51 pa zë.

LAVDI. Më nërmjetimet e Hyjlindëses, o mëshirëplót, shúaji paudhësít’ e mia.

TANI. Më nërmjetimet e Hyjlindëses, o mëshirëplót, shúaji paudhësít’ e mia.

Mëshirome, o Perëndi mëshirëplót, edhe shúaji paudhësít’ e mia.

T. II. Pjetri kur të shikój, të vdekur ty o Nënë, që jeten na ke lindur, më lot po të thërriste, kujtona pranë Zotit Krisht.

SHKURTORJA, T. T. II, TIN EN PRESVIES.

(Kjo Shkurtore këndohet që më 14-23 të Gushtit)

Zonjen që është e pafjetur për nërmjetime, dhe

shpresën tonë të patronditur për çdo mprojtje, varri dhe vdekja s' e zoteruan dot, se ishte Nen' e Jets, dhe përseri në jet' e çoj, aý qe banóje në gji të virgjër.

SHTËPIA

Forcoma mendjen o Shpëtimtár, se kuxónj ta lavderónj fortesën e botes, Nenen tende të pacinuar, se ti na je zotuar të na i mbarósh të gjitha kerkesat për shpëtim. Ti, pra, dhuro me taní gjuhë të volítime dhe mendje faqebardhë, se çdo dhuratë e mbare zbrer prej teje, o dritëprures, qe banove në gji të virgjër.

SINAKSARI

Me pesëmbëdhjetë të ketí múaji, kujtojmë Fjetjen e nderuar të Shen Marisë, Kryezonjes sonë të lavderuar, Hyjlíndesës dhe gjithënjé Virgjërëshës.

Me nermjetimet e saj, o Perendí, meshirona dhe shpëtona si i mirë dhe njeridashës.

ZBRITËSORET, T. I, PEPIKILMËNI

(Kendohen qe me 13-23 të Gushtit)

I. I lavderuar dhe i gezuar, plot me shkëlqím kujtimi yt, Marí Hyjlíndese, thirri çdo besnik ketú për të defryer shpirtërisht; ti në krye dhe në pas, me valle dhe me timpane, dhe me këngë për Birin Jesú, se nder edhe lavdí fitóje.

III. O Perendí dhe krijëtar qe përmbán, gjithësinë pa funt, me mendje dhe me fuqí, ti për-

mbaje gjithënjë, të patronitur Kishën ton' o Krisht, se ti je i vëtimi, Shenjt i Shenjtëve Perëndí dhe Zot.

IV. Fjalët edhe enigmat e Profëteve, e çpallne mishërimin tënt, prej Virgjreshës o Krisht, dritë vetëtime, përpara gjithë kómbeve, përandáj therrët me gas avusha: Njeridashes i fortë lavdí me ty.

V. Virtutat e tua qellore, do t' i tregónj nëper botën o Zoti Krisht, se me lavdí prej lavdie të përjéteshme, ndritë shkëlqeve nga qelli për njërezit, i mishëruar virgjërisht, na u-çfaqë si njerí, dhe përmi dhënë lindre si díelli.

VI. Shen Jonáj që u-gëlltít, prej balencës për çudí, dhe qëndrój tri ditë në mushkerít' e saj, në parëtrëgój varrimin tënt o Shpëtimtár; se shpëtoj me urdher Perëndie, dhe i pangarë therriste: Lavderime si thërore do të síell o Zot.

VII. Kunder zjarrit burrerisht, qëndrój mall' i perëndishme i Tre Djémve, dhe tirani u-përqësh me një vesë prej qellit, dhe të frymësuar të Tre Djemat, në mes të flagës këndonin me organe muzikale: Zot i lavderuar dhe i bekuar je, përherë dhe përjetë.

VIII. Flagë vesónjëse për Djemat, dhe për besliqte djégese, Çngjelli i Zotit u tregój besnikëve, dhe Virgjreshën e beri, burím kryesór të jetës, për të gjithë këndónjesit: Vetëm Krijëtarin e hymnojmë pa pushuar, dhe e lartësojmë përherë dhe përjetë.

MADHESHTIMET

Gjithe gjeneratat, po te lumerojne, Hyjlíndesen e vetem.

IX. U-muntne gjithe ligjat e natyres, prej teje o Hyjlíndese; se nje lindje virgjerore, dhe nje vdekje me jete po na tregón. O Virgjereshë pas lindjes edhe e gjalle pas vdekjes, ti e shpctó, trashëgimin tent o Hyjlíndese.

Engjejte, kur pane Virgjereshen, te fjetur po çudíteshin, si fluturonte prej dheut dhe po ngjitej perpjete.

IX. Gjithe njërczit, kcceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Engjejt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panair te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lumura, Virgjeresh' e kulluar Hyjlíndese.

DERGIMESORJA, III, EPESKEPSATO

Apostúj dhe miq ketú, anembanc mblídhuni, ne fshatin tim Gjethsemaní, ne varr kufomen shtjérmani; dhe ti o Bir dhe Perëndí, nga dheu merrma shpirtin, pas teje ne qiellin (*3 here*).

LAVDERIMET, T. IV, OS JENEON

Sot qe fjete plot me lavdí, Kryezonje Hyjlíndese, te kremtojne Engjejte tok me njërczit, dheu i tere te ligjerón, kendime vajtónjese, ty o Nen' e Zotit Krisht, krijetarit te bóteve, Zonje Shen Marí, Virgjereshë hirplote, qe shpetove tere gjinden njerczore, nga nje mallkím i stergjýsherve.

Anembanc Dishépujte, Apostújt' e besníkeve,

u-permblothne sot ketú per varrimin tent, dhe kur te pane qe ngriheshe, perpjete ne qiellin, me gezim dhe brohorí, te therrisin si Engjelli: "Ti je m' e lumura, Virgjereshe ne bote, Nen' e Krishtit, qe bashkove dhen' e qellin, me lindjen tende te ndrícime.

Nen' e Jetes se jéteve, drejt ne jeten po fluturón, pa ngjeruar vdekjen e mekatáreve, dhe te percjellin gjith' Engjete, dhe Forcat e qiellit, me Profét' e Apostúj, dhe Shenjtore qe s' kane funt, edhe shpirtin tent po e pret ay vete Shpetimtari, Jesú Krishti Jetedhencs, o Virgjereshe Hyjlíndese.

LAVDI DHE TANI, T. T. II. Ne Fjetjen tende te pavdekshime, o Nen' e Jetes Hyjlíndese, rete i rrembyen Apostujte, qe ishin te perndare ne bote, dhe i prunc perpara trupit tent te pacinuar. Dhe atá te varrosne, dyke kenduar dhe dyke thirrur si Gabrieli: Gezohu o Hirplote, Virgjereshe Nen' e panuseruar, Zoti eshte tok me ty. Me atá lutu-i Birit tent edhe Perendise tone, te shpetohen shpirtet tona.

HYRTORJA

Ejani t' i fálemi, dhe t' i pergjúnjemi Zotit Krisht. Shpctona o i Bir' i Perendise, i çudicim ne Shenjtoret, né qe te kendojme Alilluia.

SHKURTORJA, T. T. II, TIN EN PRESVIES

Zonjen qe esht e pafjetur per nermjetime, dhe

shpresa jon' e patronditur per çdo mprojtje, varri dhe vdekja s' e zoteruan dot, se ishte Nen' e Jetes, dhe perserí ne jet' e çoj, aý qe banój ne gji te virgjër.

APOSTULLI

Madheshtoje Zotin, o shpirti im. Se e hodhi syrin mi sherbetoren e perunjur.

Prej Letres se Palit per Filipianet.

Vellezer, kini até fryme, qe ka patur Jesú Krishti, i cili kishte formen e Perendise, dhe ishte barabár me Perendine, po e zbriti veten e tij aqe sa mori formen e sherbetorit edhe shembellsine e njeriut, edhe u-çfaq si njerí nga fytyra, dhe e perunji veten e tij, edhe u-tregua i bindur gjer ne vdekje, dhe ne vdekje mi Kryqin. Perandáj edhe Perendia e lartesój, edhe i dha nje emer permi çdo emer tjater, qe perpara até te pergjunjen te gjithë até, qe jane ne qell edhe mi dhé edhe nene dhene, edhe çdo gjuhe te refenje se Jesú Krishti eshte Zot per lavdine e Perendise dhe Zotit.

UNGGJILLI PAS LUKAJT

M' até kohë, Jesú j hyri ne nje katúnt, edhe nje grua, e quájtur Martha, e priti ne shtepine e vete. Edhe ajó kishte nje moter, te quájtur Maria, e cila ndenji ne kembet e Jesújt, edhe degjonte fjalct e tij. Po Martha sillej rotull, dhe sherbente rende, pastáj qendrój, edhe tha: "O Zot, valle nuke te ha malli qe ime-moter me ka lenë te sherbénj

e vetem? Thúaj-i, te lutem, te me ndihmonje.” Dhe Jesúj u-përgjëq, edhe i tha: “Martha, Martha, po kujdesesh edhe trubullohesh për shume gjera, po vetem për një gjë është nevojë; dhe Maria ka zgjedhur pjesën e mirë, e cila nuk do të rrembehët prej saj.” Edhe kur po i thoshte këtë fjalë, një grua prej pópullit e ngriti zërin, edhe i tha: “Lum’ barku, që të ka mbajtur, edhe siset, që ke thëthitur.” Po ai tha: “Jo, po lum’ atá, që e degjojnë fjalën e Perëndisë, dhe e rúajnë.”

MADHËSHTIMI I MESHËS, T. I.

Gjithë gjeneratat, po të lumerojnë, Hyjlíndesen e vetem.

U-muntne gjithë ligjat e natyres, prej teje o Hyjlíndese; se një lindje virgjërore, dhe një vdekje me jetë po na tregón. O Virgjëreshë pas lindjes edhe e gjallë pas vdekjes, ti e shpëtó, trashëgiminë tënt o Hyjlíndese.

KUNGATORJA

Do ta marr kupen e shpëtimit, edhe do ta përtherrës emrin e Zotit.

16. Trasferimi i Kores së Zotit tënë Jesú Krisht përmi Shamine e Shenjte; Diomedi, Deshmori i Shenjte.

PËRLESHORJA E KORES, T. II, TIN AKHRANTON IKONA SU

Konizmen e bekuar po adhurojme besërisht, dhe ndjese po të lypim për fajet dhe mekatat tona o Krisht Perëndí, se deshe dhe dignove të

mberthesh mi Kryqin truperisht, dhe nga zgjedha e djallit na shpetove dhe na dhé lirí; pra po te thërresim me perhirím: Me gas i mbushe qe te gjitha Shpetimtár Jesús, se ti ke ardhur per shpetimin e botes.

17. *Mironi, Deshmori i Shenjte.*

18. *Flori dhe Lavri, Deshmoret e Shenjte.*

19. *Andrea Stratellati, Deshmori i Shenjte.*

PERLGSHORJA E ANDREUT STRATELLATIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojtje lot e mundím, kurorë te ndrícime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, i rrezuan tiranet; edhe i shtypne djajte, e kuxímt' e te dobet; atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

20. *Samueli, Profeti i Shenjte.*

PERLGSHORJA E SAMUELIT, T. II.

Samuél Profét' i Shenjte, qe te kremtojme me besë, nermjetó perpara Zotit, te shpctohen shpirtet tona.

21. *Thadeu, Apostulli i Shenjte; Vasa, Deshmorja e Shenjte, dhe bijt' e saj, Theogni, Agapi dhe Pisti.*

PERLGSHORJA E THADEUT, T. III.

Thadé Apostúll i Shenjte, lutju Zotit tone Jesús Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

22. *Agathoniku, Deshmori i Shenjte.*

23. *Lupi, Deshmori i Shenjte.*

24. *Shen Kozmáj i Beratit.*

PGRLGSHORJA E SHEN KOZMAJT, T. IV

Le ta kremtojme Shen Kozmán' e perkujtuar, le ta lavderojme te gjithë o besnike, yllin e Deshmóreve, mburrjen e meshatárove dhe te múrgeve, se si shok i Apostujve, dhe nermjetár perpara Krishtit, u fal sherime te semúrove, qe i afrohen me besë.

LAVDI DHE TANI, T. III, EFRENESTHO

Na shkelqeve o Deshmór me nam, o Shen Kozmá si yll qe lártazi, rrojte mi dhene si Engjell, çthurre Ferrin beselik, ketú pra sot po mblídhemi, dhe me lulet e kéngeve, te mpleksim kurore me te thírrura: O Deshmór i Shenjte, dergona hirin tent, dhe shpetoji besniket, prej gjithë hélmeve.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ejani gjithë tok, me kenge ta levdojme, Kozmane qe shkelqeu, me fjale dhe me vepra, dhe vdiq i varrur si Deshmór.

Nxenes i Zotit Krisht, dhe shok i Apostujve, dhe mjek si Anargjendet, dhe shembell per besniket, fitój kurore si Deshmór.

Mblídhuni sot ketú, me lule ta stolisim, se na burón sherime, per shpirtet dhe per trupet, Deshmori Shen Kozmá me nam.

LAVDI, T. T. II. More Kryqin mi sup, Ungji-

llin e përhapë, punovë si Shen Pali, pra lutu pranë Krishtit, për ndjesën e besnikëve.

TANI. Cili s' të lumëron taní, Shen Marí Virgjëreshë? Cili vallë nuk hymënon lindjen tënde të shenjte? Se Bir' i Zotit Perëndí na ndriti i vetëmlinduri, se aý prej teje u-misherua, pa at' e pa shpjegím, si Perëndí që ishte, edhe na u-benjerí pa ndryshím përmi dhé, dhe s' ish i ndar' aspak prej natýrave, i fortë prej të dýjave, na u-njoh i paperzéri. Atí pra lutu-i, o Zonjë Hyjlíndese, të na dhuronjë hir të shpírteve.

PASVARGJET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

More forc' e hir që lartazi, si Kryetrím shembellór, i bekuar prej Shpirtit Shenjt, i dermuvë plotërisht, gjith' ordít' e demóneve; ngrite tropera, kunder barbáreve, ndrite me fjalë, besë dhe shpres' e mall; pra nermjetó për në, që kremtojmë besërisht kujtimin tënt, pranë Zotit Jesú Krisht, dhe shpirtet na shpëtó.

Fjalën e leçite plot me zell, dhe e lërove me mall, e vadite me shpres' e lot, dhe e mbollë me kujdës, nëpër zemrat e njëresve; dhe mblodhë lule, pemë edhe kallínj, plot me virtuta, dritë dhe dituri; pra nermjetó për në, që kremtojmë besërisht kujtimin tënt, pranë Zotit Jesú Krisht, dhe shpirtet na shpëtó.

Ndrite dhe shkëlqevë me virtút, Dëshmór i Shenjtë Kozmá, Ashketí i virtútave, shembell e besnikëve, dhe leçites i dógmave; dhe prediko-

ve, nje Perëndí dhe Zot, Trinín' e Shenjte, me dashurí dhe mall; pra nermjetó per né, qe kremtojme beserisht kujtimin tent, prane Zotit Jesú Krisht, dhe shpirtet na shpetó.

LAVDI. Né besniket te nderojme, o Shen Kozmá o udhcheqes i larte, se ti na mesove te baresim ne udhen e drejte. Lum' ti qe i sherbeve Krishtit, edhe i prure shumica prej besnikesh te mirepritur, o shok i Engjelijve dhe i Apostujve, kurór' e Dëshmoreve dhe e Shenjtóreve, nermjetó me atá per shpëtimin e shpërteve tona.

TANI. Prit-i Hyjlíndese, lutjet e sherbetóreve, perkrahna dhe shpëtona, prej rezíkeve dhe hélmeve.

NDËNJËGSORET, T. I, TON TAFON SU

Me besen e Jesújt, si nje shqyt dhe nje arme, shkelqeve me triúmfi, kunder gjithë armiqve, me fjale dhe me predikim, si me draper prej kóresi, preve pa pushim, çdo drize prej pabesie, dhe permbyse krejt, intrigat e te ligut.

LAVDI DHE TANI. Si Nene te Jesújt, qe te gjithë te njohim, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né, ty te kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpëtimtare ne ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

T. T. I, TON SINANARKHON

Mbolle besen e mire ne mes te njérsve, edhe kore me duaj kallínjt' e drítheve, o Dëshmór i

lavderuar Shen Kozmá, Krishtit ia shpure si nje fli, nje shumice prej besnikesh mi alltarin e larte, qe po mburren si Orthodoxe, me doktrinat e Shenjtórove.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe dhe Nene Marí Hyjlíndese, qe hidherimin e Eves e ktheve ne gczím, te hymnojme né besniket dhe te fálemi, se na çlirove ploterísht, nga mallkimi prinderór o Zonj' e permibekuar; nermjetó pra per né pa prere, qe te shpetojme prej rezíkeve.

T. III, EPEFANIS SIMERON

Kaperceve me lavdí, lumin e trubull, kur ne rymen me terbím, te hothne o Deshmór me nam, dhe ne Parajsen kalove drejt, edhe fitove, kuroren e Engjejve.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe mprójtese, per çdo nevojë, nermjetó per gjithë né, qe kemi shprese permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besnikëve.

Meqéneqe nuke ka Ungjáll te Mengjezit, kendohet me-njehere:

SHKURTORJA, T. III, EPEFANIS SIMERON

N' Etoline driten pé, ne Mal te Shenjte, i thellove si nje murk, gjithë misteret e Jesújt, dhe predikove me shpres' e mall, dhe derdhe gjakun, si nje Apostúll i tij.

SHTËPIA

Le ta nderojme o besnike, dhe le ta kurorczoj-

me me lule Shen Kozmane, bukurine e Deshmó-
reve, mburrjen e múrgëve, predikónjcsin e beses,
shémbellen e prífterve, imitatorin e mbaruar
te Apostujve, se ben çudira, dhe na dhurón
shcrime. Le ta pëshendoshim pra, dhe le t' i
thërresim: Gezohu o ligjeronjcs i beses, o kollonc
e patronditur e Kishes. Rúaje Kishen ne paqe me
nërmjetime, se ke kuraje përpara Shpetimtarit,
se derdhe gjakun si një Apostúll i tij.

SINAKSARI

Me njëzét e kater te ketí múaji, kujtojme Shen
Kozmane, Atin tone Oshenár, Hierodeshmór dhe
Isapostúll.

Gjithe sot, kujtojme Eftikun, Hierodeshmorin
e Shenjte, dishépullin e Shen Joán Theollogut.

Me nërmjetimet e tyre, o Perendí, mëshiro-
na. Amín.

ZBRITCSORET, T. T. IV, STAVRON KHARAKSAS

I. Një Kryq vijosi me shkop, Moisi Profeti,
dhe Det' i Kuq u-ça me dysh, dhe Israeli shkoj
pértéj; pastáj prapë e bashkój, me një tjtër
shkop dhe Kryq, persiper válave, dhe forcat e-
dhe qeret, Faraonit ia mbyti; pra Krishtin ken-
dojme si Perendí dhe Zot, me brohorí dhe gas.

III. Shkopi një herë si një simból i misterit na
u-çfaq; se filizat na treguan prífterine, edhe për
Kishen beronjë, ja ku mbiu edhe lulezój, Kryqi
taní, për forcë dhe për shigurím.

IV. Kam degjuar o Zoti Krisht, si e regullove keté mistér te math, kupetova veperimin tent, dhe te lavdetrova Perendia im.

V. O Drur' i lumur tri here, permi te cilin undé, Mbret' i larte Zoti Krisht, se prej teje u-rrezua djalli gjarper, i genjyer tmerrcrisht, prej Zotit te mberthyer permi Kryq, q' u fal shpírteve, perdellim dhe paqe gjithenjë.

VI. Ne barkun e bishes se detit, Profeti Shen Joná, dúarte i zgjeróje ne forme Kryqi, dhe pesimin e Krishtit paretregonte kjarisht, pra i tridicim jasht' u-hoth, dhe lajmen e perminatýreshme e parelajmeróje, te Jesújt te mberthyer mi Kryqin per né, qe na e ndriti krijesen, me ngritjen prej várreve.

VII. Urdher te cmendur dha, tirani besclík, e tundi pópullin, boten e tmerróje, me blasfemí dhe paudhesí, po te Tre Djemat nuk i tronditi dot, terbimi i eger, as furra me zjarr; dhe kur u fryri era veseprúrese, kendonin brenda mun ne zjarr: I permihymnuar je, Perendí dhe Zot i Math, per jete i bekuar.

VIII. E bekoni Djema, si Trinia nga númeri, Atin qellór te vétemin Zot, hymnoni Fjalén qe mi dhene zbriti, dhe e beri vese zjarrin e fúrrave; dhe e lartesoní, dhe Shpirtin e Terreshenjtc, qe u dhuróje qe te gjithëve jeten.

Ne Madheshtimet kendohen Troparet pasónjese:

IX. O Hyjlíndese Parajse mistike je, se pa lerím lulezove Zotin Krisht, qe mbolli permi dhé,

jeteprúresin Kryq, qe po lusim me bese, se ky po lartesohe, dhe me anen e tij, ty te madheshtojme sot.

Mallkím' i vjeter i stergjyshit, qe rodhi nga farmaqi i gjárperit, u-abolít me Kryqin e Zotit Krisht; bekimi ardhi prape per njerinc me Marí Hyjlíndesen, qe na lindi Jesunc çlirónjesin; te gjitha pra fuqite, e lavdetrojne ne qíellin.

DERGIMESORET, T. III, EPESKEPSATO

E mohove veten krejt, edhe e ngrite Kryqin tent, dhe bere shenja te medhá, o Shen Kozmá Dëshmór dhe Mjek, dhe predikove pa pushím, edhe n' alltár meshove, si Prifti i Zotit Krisht.

Na linde o Hyjlíndese, Jesunc Krishtin Perendí, qe tere boten e shpetó, nga Ferri i demóneve; shpetona nga smundjet pra, nga helmet dhe mekatat, me lutjet e dhémpshura.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Me predikime e mbolle besen e Zotit Krisht, me driten e Trinise, qe perhape ne boten, shperndave erresiren o Shen Kozmá, pran' asáj nermjetó per né, qe po kremtojmë me bese perunjesisht, dhe me buje kujtimin tent.

Lipsanin tent çudiberes me mburrje po e mban, ne gji te tij Berati, si thesár te paçmuar, qe hir edhe çudí burón gjithenjé, per sherimn' e trúpeve, dhe per shpetimin e shpírteve nga çdo vrer, i armikut o Shen Kozmá.

Dcfré Berát dhe gczohu me bes' e shprese sot, se mban ne gji thesarin, e Dëshmorit të Shenjtë, dhe Mjekut Anargjënt Kozmá që nderój, Kishen tone me lavderím, dhe na stolisi alltarin si meshtár, dhe si mburrje e múrgeve.

LAVDI, T. II. Le ta lavderojme o vellezer, Isapostullin Kozmá, zelltarin e Shen Palit, enes se zgjedhur dhe te Parit te Apostujve; se nuke ngjerój as gjume as prehje, gjer sa ua perhapi Ungjillin te gjítheve; se i nxori zemrat e besnikëve, nga gremina e genjeshtres, dhe u tregój udhen e Perendise; se vaditi shpirtet e njéresve, dhe e perndau erresiren, me driten e embel te Trinise. Me até drite ndricono edhe né o Shenjt, edhe shpetona nga leqet e armikut.

TANI. O Zonje Shen Marí, që linde Perendine, Jesune Shpetimtarin, perkrahna dhe shpetona, nga grackat e demóneve.

SHKURTORJA, T. IV, IOAKIM KE ANNA

Joakimi dhe Anna që nuke kishin femije, dhe Adami dhe Eva që ishin shtypur prej vdekjes, fituan gas dhe liri me ty, kur linde o Hyjlíndese. Até po kremtojme né besniket, se taní u-çliruan nga mekati dhe thomi: Beronja lindi Hyjlíndesen edhe Nenen e Zotit.

APOSTULLI

I drejti do te gczohet me Zotin. Degjoma zerin, o Perendí.

Prej Letres II se Palit per Timothenc.

Bir Timothé, forcohu me hirin e Jesú Krishtit, edhe ató, qe ke degjuar prej meje, me shume deshmore, ua dorezó njérsve besnike, te cilet jane te zotet tua mesojne edhe te tjéreve. Edhe duroji te keqiat, si ushtár i mire i Jesú Krishtit. Asnjé njerí, i cili vete ushtár, nuké ngaterrohet ne andrallat e jetes, po perpiqet t' i pelqenje gjeneralit te vete. Dhe askúsh nuk e fitón kuroren e trimerise veç neqóftese trimerón pas ligjes. Bujku, i cili mundohet, ka te drejte te marre nje pjese te pémeve i pari. Kupetoji ató, qe them, edhe Zoti te dhente ment per te gjitha. Kujtoje Jesú Krishtin prej fares se Davidit, i cili u-ngjáll se vdékuresh pas Ungjillit tim, per te cilin vuanj te keqia gjer ne burk si nonjé keqberes, po fjala e Perendise nuké lidhet me vargónj. Perandáj, i durónj te gjitha per te zgjédhurit, qe te gjejne edhe atá shpetimin e Jesú Krishtit edhe lavdine e pasosur.

UNGGJILLI PAS JOANIT

Zoti u tha Dishépujve: Kjo eshte porrosia ime, doni njerjatin. Neqóftese bota ju urrén, díjeni se mua me ka urryer mé pare se ju. Sikur te ishit prej botes, bota do tju deshte si te sajte, po me-qéncqe nuké jini prej botes, nga e cila ju kam zgjedhur une, perandáj bota ju urrén. Kujtójeni fjalen, qe ju thashe. Nuke ka sherbetór mé te math se i Zoti. Atá, qe me kane ndjekur mua, do tju ndjekin edhe ju. Atá, qe kane rúajtur fjalen time, do ta rúajne edhe túajen. Edhe ketó te gji-

tha do tjua bejne per emrin tim, se nuk e njohin atë, qe me ka derguar. Sikur te mos kisha ardhur dhe te mos u kisha folur, nuke do te kishin mekát. Po taní nuke kane mehane per mekatin e tyre. Aý, qe me urrén mua, urrén edhe tim-Atc. Sikur te mos kisha bere perpara tyre veprat, te cilat nuk i ka bere asnjé tjater, nuke do te kishin mekát, po taní edhe i kane pare veprat edhe me kane urryer edhe mua edhe tim-Atc. Edhe keshtú mbushen fjalet e shkrúara ne ligjen e tyre, qe me urryen darovísht. Edhe kur te vinje Ngu-shellimtari, Shpirti i se vertetes, qe dergohet prej Atit, te cilin do tjua dergónj une me anen e Atit, aý do te deshmonje per mua. Po edhe ju deshmoni, se kini qene me mua qe ne krye. Ketó jua thashe, qe te mos skandalizóheni. Do tju nxíerin jashte sinagójave, edhe vjen ora, ne te cilen atá, qe do tju vrasin, do te mburren se i bene nje sherbím Perendise.

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

25. *Kthimi i lipsanit te Barthollomeut, Apostullit te Shenjte; Titoja, Apostulli i Shenjte.*

PERLESHORJA E APOSTUJVE, T. III.

O Apostúj te Shenjte, lútjuni Zotit tone Jesú Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e míkátave.

26. *Adriani dhe Natalia, Deshmoret e Shenjte.*

27. *Pimeni, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E MOISIUT ETHIOPIT,
T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Qytetar i shkretetires edhe Engjell nga trupi, edhe çudiberes u-çfaq, o Moisi i Shenjte; me lutje vengjill' e agjerim, fitove dhuretí te qëllshime, se semundjet dhe lengatat na i shcrón, dhe ndjen mekatat e shpirtit; lavdí atí qe te fali fuqí; lavdí atí qe te dha kurore; lavdí atí qe veperón, me anen tende sherime.

29. *Kokeprerja e Joanit, Profetit, Parerëndesit, dhe Pagezorit te lavderuar.*

PERLESHORJA E PAGEZORIT, T. II.
MNIMI DHIQEU

I drejti kujtohet kudó me kenge, po ty t' arrin deshmimi i Krishtit, o Parerendes dhe Pagezór. Se vertét u-tregove mé i nderuari i Proféteve, se u-vleresove per nderin te pagezósh te parclajmeruarin. Perandáj pra u-mundove per te verteten, dhe me gezim leçite ne mes te Ferrit, se Krishti si njerí u-çfaq mi dhé, i cili ngre mekatin e botes, dhe na fal per gjithenjé meshiren e madhe.

30. *Aleksandri, Joani dhe Pali i Ri, Aterit tane te Shenjte, kryepeshkopet e Kostandinopojes.*


PERLESHORJA E ATERVE, T. IV.

O Perendí i Aterve, qe na sillesh gjithenjé, me miresí dhe urtesí, mos e kursé perdellimin tent per né; me lutjet e Atere tane, qeverís-e jeten tone me paqe.

31. *Vendosja e Brezit te çemuar te Shen Marise.*

PERLESHORJA E BREZIT, T. T. IV.

Virgjereshe dhe Hyjlíndese, edhe mprojtj' e njerezise, i fale qytetit tent Kemishen dhe Brezin e trupit tent, si keshtjelle dhe si arme kunder gjithë armiqve, se u-shenjteruan dhe mbetne te pacinúara, se me ty na çuditi edhe natyra dhe koha. Pra ty po te lútemi, dhurona paqen dhe hirin tent pópullit, dhe shpírteve tona perdellimin e math.



DOKSOLLOGJIA E FLAMURIT

PRIFTI: Lavdí Trinise se Shenjte se bashkeqénshime, jetebérese dhe se pandare, gjithenjë, taní dhe perhere, dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: O Mbret qellór, o ngushellimtar, o Shpirti i se vertetes, qe ndodhesh kúdó, dhe i mbush te gjitha, thesár i te mirave dhe fales i jetes, eja dhe tendesó ner né, dhe spastrona prej çdo njolle, dhe shpctoji shpirtet tona, o i mire.

Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

Triní e Tereshenjte, meshirona; o Zot, hircsoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona;